



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.76/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër kandidatit për Asamble nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Abdurrahman Bushi, dega në Han të Elezit, kandidatit për Asamble nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) Nexhmedin Daci, dhe kandidates - bartëse liste për Asamble nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) Kimete Kuka-Hasallari, dega e Han të Elezit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.10.2025, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.76/2025, e datës 29.09.2025, parashtruar nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatit për Asamble nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Abdurrahman Bushi, dega e Han të Elezit, kandidatit për Asamble nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Nexhmedin Daci, dhe kandidates - bartëse liste për Asamble nga LDK, Kimete Kuka-Hasallari, dega e Han të Elezit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 29.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, në të cilën theksohet se në Komunën e Hanit të Elezit, tre drejtorë komunalë vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e tyre publik edhe pse janë të certifikuar si kandidatë për Asamblenë Komunale në zgjedhjet e ardhshme, si në vijim: 1) Abdurrahman Bushi - Drejtor i Bujqësisë në Komunën e Hanit të Elezit - kandidat për Asamble nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK); 2) Nexhmedina Daci - Drejtoreshë për Urbanizëm në Komunën e Hanit të Elezit - kandidate për Asamble nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK); 3) Kimete Kuka-Hasallari - Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Hanit të Elezit - bartëse liste dhe kandidate për Asamble nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Të njëjtit kanë shkelur nenin 36 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sipas të cilit nëpunësve civilë dhe personave që

mbajnë pozita publike u ndalohet përdorimi i zyrës, burimeve dhe infrastrukturës së institucionit për qëllime zgjedhore dhe nenin 5 paragrafi 2.1 i Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 i cili përcakton se të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike nuk mund të përfshihen në fushatë gjatë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, të cilët obligohen të pezullojnë vendin e punës. Nga fakti që këta kandidatë vazhdojnë të mbajnë funksionet publike edhe pas certifikimit si kandidatë, rezulton qartë se kemi të bëjmë me një shkelje ligjore që krijon konflikt interesi dhe cenon parimin e barazisë së subjekteve politike në garë. Parashtruesja e ankesës thekson se pozita të cilën mbanë kandidati është pozitë që ndikon direkt në presion tek punëtorët, duke krijuar frikë, pasiguri, ndasi, përçarje brenda punëtorëve të ndërmarrjes gjatë fushatës zgjedhore.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), datë 29.09.2025, theksohet se drejtorët e Drejtorive Komunale nuk janë nëpunës civilë në kuptim të Ligjit Neni 25, i Ligjit Nr. 08/ L-197 për Zyrtarët Publik, por janë të emëruar politikë nga Kryetari i Komunës sipas nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Për këtë arsye, ata nuk i nënshtrohen detyrimeve që Ligji për Zyrtarët Publik parashikon për nëpunësit civilë, përfshirë pezullimin e detyrueshëm gjatë periudhës zgjedhore. Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme ndalon përdorimin e zyrës dhe burimeve institucionale për qëllime zgjedhore nga nëpunësit civilë dhe personat që mbajnë pozita publike në shërbimin civil. Dispozita nuk ndalon ushtrimin e funksionit për zyrtarët e emëruar politikisht nga kryetarët e komunave. Gjithashtu, rregullorja zgjedhore nr. 07/2024, neni 5 paragrafi 2.1, rregullon sjelljen e punonjësve në institucione shtetërore gjatë orarit të rregullt të punës, kjo normë nuk vendos detyrim pezullimin për drejtorët e emëruar politikisht, por vetëm ndalim të përdorimit të burimeve publike për fushatë. Tutje ka shtuar se PZAP nuk ka kompetencë të urdhërojë pezullimin e tyre përderisa nuk ka shkelje të drejtpërdrejtë të Ligjit Zgjedhor, për këto arsye, kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja që ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ta refuzojë si të pabazuar.

Në përgjigje në ankesë të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), datë 30.09.2025, theksohet se Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka shpërndarë udhëzimet përkatëse dhe ka njoftuar të gjithë kandidatët e saj për asamblë komunale, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, lidhur me detyrimin për respektimin e rregullave zgjedhore të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet Lokale, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në Kodin e Mirësjelljes. Tutje ka shtuar se ankuesi nuk ka ofruar asnjë argument të qartë dhe të qëndrueshëm ligjor që mbështet kërkesën e tij, duke e bërë ankesën të paplotë dhe të paargumentuar. Mungesa e argumenteve të tilla tregon se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë bazë ligjore që të mbështesë pretendimet e tij, dhe kjo do të thotë se ankesa nuk është e strukturuar siç kërkon ligji. Për më tepër, ankuesi nuk ka bashkëngjitur asnjë provë që të vërtetojë kërkesën, duke e lënë të pasigurt dhe të paplotë procesin e shqyrtimit të çështjes. Pa një argumentim të bazuar dhe provë të qartë, ankesat e tilla mund të konsiderohen të paqëndrueshme. Prandaj, kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja që ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ta refuzojë si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- **Ankesa është e pa bazuar**

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që paraqitësja e ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi, dhe si e tillë nuk mund të vërtetohet se tre drejtorët komunal dhe njëkohësisht kandidatët për asamble në komunën e Hanit të Elezit përkatësisht: 1) Abdurrahman Bushi kandidat për Asamble nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK); 2) Nexhmedin Daci kandidat për Asamble nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe 3) Kimete Kuka-Hasallari bartëse liste dhe kandidate për Asamble nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kanë bërë shkelje të nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës se *“personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyrë apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*.

Parashtruesja e ankesës subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në ankesën ZL.Anr.76/2025 të datës 29.09.2025, nuk ka konstatuar asnjë veprim konkret apo kohën e kryerjes së veprimit, si rrjedhojë nuk mund të verifikohet përmbushja e afatit ligjor për paraqitjen e ankesës. Tutje, e njëjta nuk ka bashkangjitur asnjë provë dhe nuk ka dëshmuar se të njëjtit kandidat për asamble komunale të Hanit të Elezit, kanë bërë shkeljen e pretenduar, rrjedhimisht nuk ka mundur të argumentoj në asnjë moment, në mënyrë të qartë dhe bindëse se në objektin e punës konkretisht në drejtorit e komunës së Hanit të Elezit të cekura në ankesë, kandidatet në pozitat e tyre përkatësisht të drejtorit të Bujqësisë në Komunën e Hanit të Elezit, drejtorit për Urbanizëm dhe drejtoreshës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Hanit të Elezit, kanë shfrytëzuar ambientit të zyrës duke përdorur pozitën publike, për të zhvilluar fushatë për subjektet politike PDK dhe LDK, ashtu siç pretendon pala ankuese. Paneli, në mungesë të provave nuk ka mundur të konstatoj nëse të njëjtit kanë ndikuar në presion tek punëtorët, duke krijuar frikë, pasiguri, ndasi, përçarje brenda punëtorëve të ndërmarrjes gjatë fushatës zgjedhore.

Paneli vlerësoj edhe pretendimet ankimore se kandidatet e subjekteve të lartcekur edhe pse janë të obliguar nuk kanë pezulluar vendin e punës dhe se këta kandidatë vazhdojnë të mbajnë funksionet publike edhe pas certifikimit si kandidatë. Mirëpo as këto pretendime nuk qëndrojnë, ngase sipas neni 58 dhe 62 nen par. 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, drejtoret komunal janë të emëruar politik nga se emërohen dhe shkarkohen nga kryetari i komunës, e sipas nenit 3 të Ligji për Zyrtarët Publik, nuk i nënshtrohen detyrimeve që parashikohen me ligjin për zyrtarët publik, e në këtë rast përfshirë pezullimin e detyrueshëm gjatë periudhës zgjedhore. Paneli ka parasysh se me nenin 36 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, ndalohet përdorimi i zyrës dhe burimeve institucionale për qëllime zgjedhore nga nëpunësit publik dhe personat që mbajnë pozita publike, e gjithashtu rregullorja zgjedhore nr. 07/2024, neni 5 paragrafi 2.1, rregullon sjelljen e punonjësve në institucione shtetërore dhe publike gjatë orarit të rregullt të punës, por asnjëra nga to nuk vendos detyrim pezullimin për drejtorët e emëruar politikisht, por vetëm ndalim të përdorimit të burimeve publike për fushatë zgjedhore.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se pretendimet e përshkruara në ankesë parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se kandidatet e lartcekura kane ndërmarr veprime qe paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.76/2025 më datë 01.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.